



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 11971 Prot.

Tiranë më, 14 / 5 /2019

UDHËZIM

Ma-10, 14.5.19

**MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE QË DUHET TË PLOTËSOJNË
SUBJEKTET QË APLIKOJNË PËR T'U PAISUR ME AUTORIZIM PËR PRODHIM DHE
IMPORTITMTË LETRËS SË CIGAREVE NË FORMËN E BROSHURAVE APO TË
TUBAVE DHE TË FILTRIT TË CIGARES**

Në zbatim të nenit 80/1 të ligjit nr.61/102 " Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe pikës 1 (b)(i), të Pjesës VIII/I , të VKM Nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave. "Për personelin e Administratës Doganore", të ndryshuar;

Me qëllim përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe afatin e autorizimit, për importimin dhe prodhimin e letrës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave që përfshihen në kodin 4813 1000, të filtrit të cigares që përfshihet në kodin 4823 dhe 5601 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave,

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Të gjithë importuesit dhe prodhuesit e letrës së cigareve, në formën e broshurave apo të tubave që përfshihen në kodet 48131 000, të filtrit të cigares që përfshihet në kodin 4823 dhe 5601 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, duhet të jenë grumbullues - përpunues të duhanit, të pajisur me linja me cikël të plotë përpunimi dhe paketimi për tregëtim, të cilët disponojnë autorizim depozitues i miratuar magazine fiskale prodhimi. Modeli i autorizimit jepet në Aneksin 1, bashkangjitur, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
2. Modeli i aplikimit/kërkesë për miratim autorizimi jepet në Aneksin 2 të pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. Modeli i aplikimit/kerkesës plotësohet. nënshkruhet nga subjekti që kërkon të pajiset me autorizim.
3. Mbajtësi i autorizimit, është i detyruar që për çdo ndryshim të adresës ku ushtron aktivitetin e importimit/magazinimit/prodhimit të letrës së cigares dhe të filtrave, të njoftojë me shkrim DPD si dhe të plotësojë të gjitha kushtet e parashikuara në autorizim.
4. Mbajtësi i autorizimit, është i detyruar të mbajë regjistrime në regjistra të posaçëm për stokun lidhur me lëvizjet e letrës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave, dhe të filtrave.

II. KUSHTET, KRITERET PER MARRJEN E AUTORIZIMIT

1. Aplikimit/kërkesës, i bashkangjitet i gjithë dokumentacioni i nevojshem që vërteton plotësimin e kushteve/kritereve, përfshirë edhe kopje të autorizimit si depozitues i miratuar magazine fiskale prodhimi, dhe paraqitet pranë Departamentit Teknik të Akcizës dhe Proçedurave Doganore në DPD.
2. Struktura teknike e akcizës në DPD, merr ne shqyrtim aplikimin/kerkesën e subjektit, kryhen verifikimin dokumentar, dhe brenda një afati 15 ditor e miraton ose refuzon atë.
3. Autorizimi jepet me afat një vit kalendarik, me të drejtë rinovimi për një vit. Çdo autorizim përmban një numer rendor. Pas miratimit të autorizimit, struktura teknike e akcizës në DPD, kryen veprimet e regjistrimit në sistemin ASYCUDA WORLD (kod shtesë për secilin nga produktet).
4. Përveç kopjes së autorizimit të Magazinës Fiskale të prodhimit, për t'u pajisur me autorizim për prodhim dhe importim të letrës së cigareve dhe filtrave, aplikuesit duhet të dëshmojnë se disponojnë linja teknologjike dhe burime njerzore të specializuara në linja prodhimi me cikël të plotë nga përpunimi gjethëve, tharja, fermentimi, grirja, paketimi, me kapacite përpunuese dhe magazinimi jo më pak se 1000 kg në orë dhe duhet të jetë e pajisur me:
 - Licencë ushtrimi aktiviteti të tipit II 5C1 dhe II 5C2 të lëshuar nga Q.K.B.
 - Furrë tharje dhe fermentimi
 - Makineri për Eliminimin e materialeve joduhanore
 - Dhome vakumi
 - Cilinder për kondicionimin dhe shtimin e lengjeve
 - Siloset e harmonizimit
 - Makinë grirje duhani
 - Cilindër tharje
 - Silosët e ruajtjes së duhanit të grirë
 - Makinat e paketimit
 - Presat për presimin e duhanit
 - Laborator për analizat bazë të duhanit sipas standardeve në fuqi
5. Aplikuesi duhet të dëshmojë se ka të punësuar personel të kualifikuar dhe të çertifikuar me licencë për grumbullim dhe përpunim duhani jo më pak se 50 punonjës me kohë të plotë.

III.DISPOZITA TE FUNDIT


1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Degët Doganore, Departamenti Teknik i Akcizës dhe Proçedurave Doganore, Departamenti i analizave dhe aposteriorit, Departamenti Operativo- Hetimor dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në DPD.
2. Produktet letrër cigare në formën e broshurave apo të tubave që përfshihen në kodin 4813 1000, filtër cigare që përfshihet në kodin 4823 dhe 5601 të Nomenklaturës së Kombinuar të

Mallrave, të importuara nga subjekte të pajisur me autorizim të Regjimit të përpunimit Aktiv, nuk i nënshtrohen përcaktimeve të këtij udhëzimi.

3. Udhëzimi nr. 6 datë 27.02.2018, si dhe urdhëri me nr. 30711 prot, datë 29.I2.2016 i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, dhe publikohet në faqen e internetit të DPD.

Arlind Gjokuta
DREJTOR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
Departamenti Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore

Nr. _____ Prot.

Tiranë më, ____/____/2019

Autorizim Nr. _____

Për "Importimin/Prodhim e letrës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave dhe filtrave

1. Mbajtësi i Autorizimit

Emri: _____

NIPT(NUIS) _____

Nr. i Autorizimit të Depozituesit të miratuar: _____

2. Adresa e plotë: _____

Email: _____

3. Destinacioni i përdorimit _____**4. Periudha e vlefshmërisë**

Ky autorizim është i vlefshëm deri më: data/Muaji/viti

5. Mallrat

Klasifikimi Tarifor	Përshkrimi	Sasia në Kg

Zv/DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Kërkesë**Drejtuar: Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave**

Lënda: Aplikim/Kërkesë për t'u pajisur me autorizim importi/prodhimi të Letrës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave që përfshihen në kodin 4813 1000 dhe filtra që përfshihen në kodin 4823 dhe 5601 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

Unë i nënshkruari,

me Nr. NIPT:

dhe me adresë:

e mail:

kërkoj miratimin për t'upajisur me autorizim importi/prodhimi të letrës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave si dhe të filtrave, që përfshihen në kodin 4813 1000 dhe filtra që përfshihen në kodin 4823 dhe 5601 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, si vijon:

Mallrat

Klasifikimi Tarifor	Përshkrimi	Sasia në Kg

1. Natyra e përdorimit final:

2. Periudha kohore e autorizimit:

3. Dokumentat bashkëngiitur:

- 1
- 2
- 3
- 4
- 5
- 6
- 7
- 8
- 9

Administratori

_____ më ____ / ____ / 2019